

I. Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 Dhjetor 2016

shënime	Per vitin e mbyllur	
	më 31.12.2016	më 31.12.2015
AKTIVET		
Aktivitet afatgjata	10,105,934,018	10,692,163,124
Aktivitet afatgjata materiale	5 10,105,934,018	10,692,163,124
Investime në Proçes	0	0
Aktivitet afatgjata jomateriale	-	-
	10,105,934,018	10,692,163,124
Aktivitet afatshkurtra		
Inventare	6 1,189,269,291	1,193,296,622
Llogari të arkëtueshme tregëtare	0	0
Llogari të arkëtueshme e të tjera	7 56,668,082	381,764,819
Shpenzime për tu shperndarë	8 26,447,014	-
Mjetet monetare në arkë e në bankë	9 739,928,379	745,180,253
	2,012,312,766	2,320,241,694
Totali i aktiveve	12,118,246,784	13,012,404,818
KAPITALI DHE DETYRIMET		
Kapitali	(2,423,101,404)	(1,266,634,986)
Kapitali aksionar	31,204,000	31,204,000
Rezerva ligjore	1,560,200	1,560,200
Rezerva të tjera	225,747,682	225,747,682
Fitime/Humbje të mbartura	(1,525,146,871)	(8,924,079)
Fitimi /Humbje e ushtrimit	(1,156,466,355)	(1,516,222,789)
	(2,423,101,344)	(1,266,634,986)
Totali i kapitalit	10 (2,423,101,344)	(1,266,634,986)
DETYRIMET		
Detyrime afatgjata	6,124,738,185	7,753,924,769
Hua afatgjata	11 6,066,490,930	7,694,740,765
Grante,te ardhura të shtyra e të tjera detyrime	12 58,247,255	59,184,004
Detyrime të tjera afatgjata	-	-
	6,124,738,185	7,753,924,769
Detyrime afatshkurtra		
Hua afatshkurtra	13 8,387,431,704	6,468,132,849
Llogari të pagueshme (furnitorë)	14 23,477,249	49,684,737
Detyrime Tatimore	15 2,165,566	2,108,826
Llogari të pagueshme të tjera	16 3,535,425	5,188,623
	8,416,609,943	6,525,115,035
Totali i detyrimeve	14,541,348,129	14,279,039,804
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	12,118,246,785	13,012,404,818

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 9 deri në 28, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Besnik KENDEZI
Administrator i TEC Vlorë sh.a

Dorina KAMBERAJ
Hartues i pasqyrave financiare

Vullnet BILBILAJ
Drejtor i Drejtorise Ekonomike



Handwritten signature in blue ink.

Handwritten signature in blue ink.

II. Pasqyra e të Ardhurave Gjithpërfshirëse më 31 Dhjetor 2016

	shënime	Per vitin e mbyllur më 31.12.2016	Per vitin e mbyllur më 31.12.2015
Te ardhura nga shitja energjise	17	-	-
Te ardhura te tjera	18	4,348,289	3,691,132
Materiale te para dhe te konsumueshme	19	(10,189,122)	(15,033,447)
Shpenzime personeli	20	(64,759,296)	(64,307,673)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	21	(916,471,861)	(1,082,541,249)
Shpenzime te tjera	22	(40,572,306)	(72,683,789)
Fitimi operativ		(1,027,644,295)	(1,230,875,026)
Te Ardhura /Shpenzime interesa Neto	23	(227,232,240)	(249,410,274)
Te Ardhura /Shpenzime kembimi Neto		98,410,177	(35,937,492)
Rezultati total financiare		(128,822,063)	(285,347,766)
Fitimi para tatimit	24	(1,156,466,358)	(1,516,222,792)
Efektet e tatimit te shtyre Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		-	-
Fitimi i vitit		(1,156,466,358)	(1,516,222,792)
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i te ardhurave te tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Fitimi qe i atribuohet aksionareve te kompanisë mëmë		-	-
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse qe i përket aksionareve te kompanisë mëmë		(1,156,466,358)	(1,516,222,792)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 9 deri në 28, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Besnik KENDEZI
Administrator i TEC Vlore sh.a



Dorina KAMBERAJ
Hartues i pasqyrave financiare

Vullnet BILBILAJ
Drejtor i Drejtorise Ekonomike

IV. Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

	<i>Per vitin e mbyllur më 31.12.2016</i>	<i>Per vitin e mbyllur më 31.12.2015</i>
Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit	(296,370,763)	(792,620,134)
Fitimi para tatimit	(1,156,466,358)	(1,516,222,792)
Shuma e mare nga Permbarimi	-	-
Rregullime për:		
Amortizimin i AAM	586,159,237	587,072,314
Zhvleresimi I Llog.arketueshme	330,312,624	495,468,935
Efektet e tatimit te fitimit	-	-
Te ardhura nga grantet dhe subvencionet	(936,748)	(3,429,675)
Vlera kontabel neto e aktiveve te shitura	-	294,816
Efektet e tatimit te shtyre	-	-
Levizjet ne Kapitali Qarkullues		
Rritje(-)/rënie(+) në tepricën e kërkesave të arkët	(5,215,887)	(11,056,531)
Rritje(-)/rënie(+) në tepricën e shpenzime per tu shperndare	(26,447,014)	-
Rritje/rënie në tepricën inventarit	4,027,330	(3,809,724)
Rritje/rënie në llogarite e furnitoreve	(26,207,488)	29,401,598
Rritje/rënie në llogarite te tjera te pagueshme	(1,653,198)	(17,972,757)
Rritje/rënie në marredheniet me buxhetin	56,740	(22,053,694)
Mjetet Monetare neto nga aktivitetet e shfrytëzimit	(296,370,763)	(462,307,510)
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese		
Blerja e aktiveve afatgjata material	69,869	(6,101,100)
Rivleresimi i asetëve	-	-
Të ardhura nga shitja e pajisjeve	-	-
Mjete Monetare neto e përdorur në aktivitetet investuese	69,869	(6,101,100)
Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare		
Hua te arketuara (e pa paguar)	291,049,020	457,273,412
Hua te Paguara	-	-
Mjete Monetare neto e përdorur në aktivitetet financiare	291,049,020	457,273,412
Rritja (+)/rënia(-) neto e mjeteve monetare	(5,251,874)	(11,135,198)
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël	745,180,251	756,315,449
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël	739,928,377	745,180,251

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 9 deri në 28, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Besnik KENDEZI
Administratori i TEC Vlore sh.a



Dorina KAMBERAJ
Hartues i pasqyrave financiare

Vullnet BILBILAJ
Drejtor i Drejtorise Ekonomike

Termocentrali Vlorë sh.a viti 2016

(Vlerat janë në Lek)

III. Pasqyra e ndryshimeve në Kapital për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016

	Kapitali i aksionar	Rezerva ligjore	Rezerva te tjera	Fitime te Mbartura /Humbje te akumuluar	Fitimi (humbje) e vitit financiar	Totali
01 Janar 2015	31,204,000	1,560,200	225,747,682	0	(8,924,079)	249,587,803
Miratimi i rezultatit te vitit 2014						
Transaksionet me pronaret	31,204,000	1,560,200	225,747,682	0	(8,924,079)	249,587,803
Korigjim i rezultatit te periudhes paraardhese				(8,924,079)	8,924,079	
Fitimi(humbje) neto për periudhën kontabël 2015					(1,516,222,789)	(1,516,222,789)
Pozicioni më 31 dhjetor 2015	31,204,000	1,560,200	225,747,682	(8,924,079)	(1,516,222,789)	(1,266,634,986)
01 Janar 2016	31,204,000	1,560,200	225,747,682	(8,924,079)	(1,516,222,789)	(1,266,634,986)
Miratimi i rezultatit te vitit 2015				(1,516,222,789)	1,516,222,789	
Transaksionet me pronaret	31,204,000	1,560,200	225,747,682	(1,525,146,868)	-	(1,266,634,986)
Fitimi(humbje) neto për periudhën kontabël 2016					(1,156,466,355)	(1,156,466,355)
Pozicioni më 31 dhjetor 2016	31,204,000	1,560,200	225,747,682	(1,525,146,868)	(1,156,466,355)	(2,423,101,340)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 9 deri në 28, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Besnik KENDEZI

Administrator i TBC Vlorë sh.a

Dorina KAMBERAJ

Hartues i pasqyrave financiare

Vullnet BILBILAJ

Drejtor i Drejtorise Ekonomike



V. Shënime Mbi Pasqyrat Financiare

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "Termocentrali Vlorë" sh.a është krijuar juridiksht me vendimin e Gjykatës nr. 3862 ,date 18.06.2007 si dhe është regjistruar në QKR më datën 22.12.2007. Selia e Shoqërisë ndodhet në Portin e ri, "Komuna Qender" , Vlorë. NIPT-i i Shoqërisë është K72422003G. Administratori i Shoqërisë është Z.Besnik Këndezi. Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është prodhimi, importi , eksporti dhe furnizimi i energjisë elektrike . Shoqëria është një shoqëri aksionere me një kapital prej 31,204,000 Lekë i ndarë në 31,204 aksione me vlerë nominale prej 1,000 Lekë.

Keshilli Mbikqyres përbëhet:

1.	Ridvan Kaja	Kryetar
2.	Mëno Besimaj	Anetar
3.	Dardan Malaj	Anetar
4.	Romeo Kara	Anetar
5.	Miranda Lila	Anetar
6.	Nexhat Hajdari	Anetar
7.	Eglantina Troplini	Sekretare

Numri mesatar i të punësuarve deri më 31.12.2016 është 61 punonjes;[2015:-61]

2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

2.1. Standardet dhe interpretimet efektive ne periudhen aktuale

Standardet dhe interpretimet e mëposhtme aplikohen për herë të parë për periudhat e raportimit financiar që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2016.

Ndryshime SNRF 5 – *Aktivet Afatgjata që Mbahen për t'u Shitur dhe Operacionet jo të vijueshme*" (publikuar në Shtator 2014 dhe efektiv në periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janar 2016)

Ndryshime SNRF 9 – *"Instrumentat Financiare"* (publikuar në korrik 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më 1 Janar 2018, por që mund të adaptohen paraprakisht për periudha financiare që fillojnë më 1 shkurt 2015).

Ndryshime SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 28 – *"Investimet në pjesëmarrje: Aplikimi i përjashtimeve të konsolidimit"* (publikuar në Dhjetor 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më 1 janar 2016).

Ndryshime SNRF11–*"Kontabilizimi i blerjeve të Pjesëmarrjeve në Marrëveshje të Përbashkëta"* (publikuar në maj 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më Janar 2016.

Ndryshime SNRF 14 – *"Llogaritë e Shtyra për Arsye Rregullatore"* (publikuar në janar 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më Janar 2016).

Ndryshime SNRF 15 – *"Të ardhurat nga Kontratat me Klientët"* (publikuar në maj 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më ose mbas 1 janar 2018, por që mund të adaptohen paraprakisht)

Ndryshime SNK 1 – *"Iniciativë mbi Dhënie Informacionesh Shpjeguese"* (publikuar në dhjetor 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më ose mbas 1 janar 2016).

Ndryshime SNK 16 dhe SNK 38 – *"Qartësimi i Metodave të Pranueshme të Amortizimit dhe Zhvlerësimit"* (publikuar në Maj 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më ose mbas datës 1 janar 2016).

Ndryshime SNK 16 dhe SNK 41 – *"Bujqësia: Bimët Bartëse"* (publikuar në qershor 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më ose mbas dates 1 janar 2016).

Ndryshime SNK 27 – *"Metoda e Kapitalit në pasqyrat financiare individuale"* (publikuar në gusht 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më ose mbas 1 janar 2016).

Amendimi ndaj SNK 19 – “Përfitimet e punonjësve” (publikuar në Shtator 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janar 2016). Ndryshimet sqarojnë kontabilizimin për përfitimeve e punonjësve të cilat kërkojnë që punonjësit apo ndonjë palë e tretë të kontribuojnë drejt kostos së përfitimeve. Këto ndryshime lejojnë kontributet që lidhen me shërbimet, por që nuk ndryshojnë me jetëgjatësinë e shërbimit të punonjësit, (p.sh. si një % fikse ndaj pagës), të zbriten nga kosto e përfitimeve gjatë periudhës që shërbimi është ofruar. Për këtë, shumë entitete mund të vazhdojnë (por nuk janë të detyruara) të kontabilizojnë kontributet e punonjësve duke përdorur politikat e tyre aktuale të kontabilizimit.

2.2. Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të pa përvetësuara

Në datën e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e mëposhtme, interpretimet dhe rishikimet janë emtuar por nuk janë ende efektive:

Deri më datë / /2017, standardet dhe interpretimet si më poshtë të publikuara nuk kanë qenë të detyrueshme për periudha raportuese që mbarojnë më 31 dhjetor 2016:

Ndryshime SNRF 2 – “Pagesa në bazë aksioni” publikuar në Qershor 2016 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më 1 janar 2018. Ndryshime për të sqaruar klasifikimin dhe matjen e transaksioneve të pagesave të bazuara në aksione.

Ndryshime SNRF 4 – “Kontratat e sigurimit” publikuar në Shtator 2016 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më 1 janar 2018. [Njësia ekonomike zgjedh të zbatojë qasjen /mbulimin në mënyrë retrospektive në asetet kualifikuese financiare, e zbaton këtë kur ajo më përpara ka zbatuar SNRF 9. Njësia ekonomike zgjedh të zbatojë metoda e shtyrjes dhe e aplikon këtë për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2018].

Ndryshime SNRF 10 dhe SNK 28 – “Shitja apo kontributi i aktiveve ndërmjet një investitori dhe partnerit në një sipërmarrje të përbashkët” (publikuar në shtator 2014, dhe me datë efektive të shtyrë derin në një deklaram të dytë).

Ndryshime SNRF 16 – “Qiratë” (publikuar në Janar 2016, dhe me datë efektive periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janar 2019).

Ndryshime SNK 7 – “Paqyra e levizjes së parasë ” publikuar në Janar 2016, dhe me datë efektive periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janar 2017.

Ndryshime SNK 12 – “Tatimi mbi të ardhura ” publikuar në Janar 2016 me datë efektive periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janar 2017 [Ndryshimet në lidhje me njohjen e aktiveve tatimore të shtyra për humbjet e përealizuara]. Kompania ka zgjedhur të mos i përvetësojë këto standarde, rishikime dhe interpretime para datës që ato do të bëhen efektive. Kompania parashikon se përvetësimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të kompanisë në periudhën e aplikimit fillestar të tyre.

3. Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të publikuara nga Bordi i Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (“IASB”) dhe interpretimeve të publikuara nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimeve Financiare Ndërkombëtare (“IFRIC”) të IASB.

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e vlerësimit të specifikuara nga SNRF për çdo klasë të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave gjithpërfshirëse. Bazat e matjes përshkruhen në detaje në politikat kontabël të më poshtme.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e disa çmuarjeve kritike kontabël. Gjithashtu kjo kërkon që drejtimi të përdorë gjykimin e tij në procesin e përdorimit të politikave kontabël të Shoqërisë. Fushat që përfshijnë një nivel të lartë gjykimi apo kompleksiteti ose fushat ku supozimet dhe çmuarjet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare paraqiten në shënimet përkatësisht.

Pasqyrat financiare janë përgatitur për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016.
Të dhënat aktuale në këto pasqyra financiare janë të shprehura në Lek.

3.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

3.2. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar. Për vitin 2015 dhe për vitin 2016, ndryshe nga vitet e mëparshme, duke qënë se Termocentrali Vlore sh.a. nuk është në funksion, Enti Rregulltator i Energjise ("ERE") nuk i ka miratuar një çmim prodhim të energjisë dhe për pasoje as kuotën fikse mbi bazen e të cilit TEC-i financohej nga Korporata Elektroergjitike Shqiptare. Për rrjedhojë edhe për vitin 2016 shoqëria nuk ka realizuar të ardhura dhe është me rezultat negativ. Mbulimi i shpenzimeve të TEC Vlorë bëhet nga KESH sha. Në rast të vazhdimit të mosfunksionimit të TEC-it, shoqëria mund të vendoset përballë vështirësive financiare dhe bllokimit të aktivitetit të saj por mbulimi i shpenzimeve të TEC Vlorë sh.a. do të bëhet nga KESH sha.

3.3. Krahasueshmëria

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabël të Shoqërisë dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas Standarteve Nderkombetare të Raportimit Financiar.

3.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

3.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

3.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

3.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të

shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

4. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

4.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e pasqyrave financiare. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 është detajuar si më poshtë:

Kurse e kembimit	31.12.2016	31.12.2015
Euro/Leke	135.23	137.28
USD/ Leke	128.17	125.79
GBP/Leke	157.56	186.59

4.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit si edhe investime të tjera tejet likuide.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Rënia në vlerë e aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet që ka pësuar një rënie në vlerë nëse ka evidencë objektive që tregon se një ose disa ngjarje kanë pasur efekt negative mbi flukset e ardhshme monetare të këtij aktivi.

Një humbje nga rënia në vlerë në lidhje me një aktiv financiar matur me kosto të amortizuar llogaritet si diferencë mes vlerës së tij kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të skontuara me normën origjinale efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme individualisht testohen për rënie në vlerë mbi baza individuale. Aktivet financiare të mbetura vlerësohen në grupe që ndajnë karakteristika të ngjashme në lidhje me rreziqet kredituese. Të gjitha humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga rënia në vlerë rimerret nëse rimarrja mund të lidhet në mënyrë objektive me një ngjarje që ndodh pasi humbja është njohur. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale të aksioneve

4.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale

prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur koston e tyre historike dhe përfshirjen e të gjitha shpenzimeve të kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike.

4.4. Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin(+/-) dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivit afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi i aktiveve Afatgjatë Materiale (AAM) llogaritet me **metodë linare** sipas jetës së vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material për: (i) Ndërtesa; (ii) Ndërtesa dhe Instalime; (iii) Makineritë e Paisjet duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2016 dhe 2015 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Amortizimi
Ndërtesa	50 vite
Ndërtime dhe instalime	20-50 vite
Makineri dhe pajisje	15-25 vite

Kjo metodë zbatohet për asetet e transferuara nga KESH sh.a. në vitin 2012. Gjithashtu ekziston një grup asetesh në klasën Makineritë e Paisjet të cilat janë blerë nga shoqëria vit pas viti, amortizimi i të cilave llogaritet me **metodën e amortizimit të vlerës së mbetur**.

Ndërsa: (i) Mjetet e Transportit; (ii) Paisjet e zyrës; (iii) Paisjet Informatike llogaritet me **metodën e amortizimit të vlerës së mbetur** sipas normave fiskale duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.

Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4.5. Aktivet afatgjatë jo-materile

Aktivitet afatgjatë jo-materiale të blera nga shoqëria paraqiten me koston historike minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje tjetër nga rënia në vlerë (nëse ka), bazuar në jetëgjatësinë e vlerësuar pas datës

së cilës ato janë te gatshme për përdorim. Jetëgjatësia dhe metoda e amortizimit të aktiveve jo-materiale shqyrtohet në çdo datë të pasqyrës së pozicionit financiar dhe efektet e ndryshimit merren parasysh në periudhat e ardhshme.

Kategorite	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Programe kompjuterike	Mbi vlerer e mbetur	25%
Licensa	Metoda lineare	15%

Shpenzimet e kërkimit dhe zhvillimit

Shpenzimet e kryera për zhvillimin e projekteve (Aktivet afatgjata jo-materiale) të blera nga Shoqëria janë paraqitur me kosto të pakësuar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar të rënies në vlerë (SNK 38), duke konsideruar mundësinë komerciale dhe teknologjike, ku edhe kostot mund të maten në mënyrë të besueshme. Shpenzimet vijuese të aktiveve afatgjata të patrupëzuara kapitalizohen vetëm kur rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike nga aktivet specifike me të cilat lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera shpenzohen në momentin që ndodhin.

4.6. Zhvlersimi i aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të shoqërisë, përveç inventarit dhe tatimit të shtyrë aktivitet rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për rënie në vlerë. Nëse një tregues i tillë ekziston atëherë matet vlera e rikuperueshme e aktivitet. Një humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël është më e madhe sesa vlera e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Shuma e rikuperueshme e një aktivi është vlera më e madhe mes vlerës në përdorim dhe vlerës së tregut minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme monetare skontohehen me një normë skontimi para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqet specifike që lidhen me aktivin. Humbjet nga rënia në vlerë të njohura në periudha të mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për ndonjë tregues rreth zvogëlimit ose eliminimit të humbjes. Një humbje nga rënia në vlerë rikthehet nëse ka pasur një ndryshim në treguesit e përdorur për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme. Një humbje nga rënia në vlerë rimerret vetëm në masën në të cilën vlera kontabël e aktivitet nuk e kalon vlerën e aktivitet që duhet të përcaktohet, neto nga amortizimi dhe zhvlerësimi, nëse asnjë humbje nga rënia në vlerë nuk do të ishte njohur.

4.7. Kosto e huamarrjes

Kostot e huave të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e aktiveve, të cilat duan një kohë të gjatë për t'u sjellë në formë përfundimtare, në mënyrë që të përdoren apo shiten, i shtohen kostos së këtyre aktiveve. Kostot e huamarrjes kanë të bëjmë me interesin dhe kosto të tjera që janë bërë nga një shoqëri në lidhje me marrjen e fondeve

Të gjitha kostot e tjera njihen si të ardhura ose shpenzime në periudhën kur ato kanë ndodhur.

4.8. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Të ardhura nga shitja e energjisë elektrike

Të ardhurat nga shitja e energjisë elektrike njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve bazuar në sasinë aktuale të energjisë elektrike të shitur.

ERE per periudhen deri ne fund te vitit 2014 ka aprovuar çmimin e shitjes së energjisë brenda kontekstit të modelit të tregut ku Shoqëria optimizon aktivet e saj dhe portofolin e kontratave nëpërmjet një metode bazuar në analiza të hollësishme të ofertës dhe kërkesës dhe në vlerësime të vazhdueshme. Për vitin 2015 dhe per vitin 2016 Shoqëria nuk ka kuota të caktuara nga ERE.

4.9. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

4.10. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

4.11. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2016 është 15% (2015: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

4.12. Përfitimet e punonjësve

Fondet e sigurimeve shoqërore, pensionale dhe të shëndetit

Sipas legjislacionit shqiptar në fuqi shoqëria është e detyruar të kryejë kontribute fikse për llogari të punonjësve në një fond të administruar nga qeveria. Të gjitha këto pagesa/detyrime njihen si shpenzim në periudhën të cilës i përkasin.

Përfitimet në përfundim të marrëdhënieve të punës

Sipas kontratës kolektive të punës, në rast të përfundimit të kontratës së punësimit pasi punonjësi ka arritur moshën e kërkuar me ligj për daljen në pension, pavarësisht nga arsyeja e përfundimit, punonjësi ka të drejtën e një kompensimi prej 2 pagash mujore bruto.

Përfitimet në përfundimin e kontratës njihen si shpenzim kur shoqëria është e përkushtuar përndonjë mundësi realiste tërheqje ndaj një plani formal dhe të detajuar që të përfundojë kontratën përpara datës normale të daljes në pension ose të sigurojë përfitimet e përfundimit si rezultat i një oferte për të përkrahur sigurimin vullnetar. Përfitimet në përfundimin e kontratës për sigurimet vullnetare njihen si një shpenzim nëse shoqëria ka bërë një ofertë për sigurimin vullnetar dhe është e mundshme që oferta do pranohet dhe numri i pranimeve mund të matet në mënyrë të besueshme.

4.13. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

4.14. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

4.15. Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

Termocentrali Vlorë sh.a
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016
(Vlerat janë në Lek)

5. Aktivet afatgjata materiale

	Toka	Ndërtime	Ndërtime & Instalime	Makinëri dhe pajisje	Mjete Transporti	Pajisje informatike	Inventar ekonomik	Total
Vlera bruto e AAM me 31.12.2015	-	243,037,367	2,354,562,445	10,614,932,122	2,729,973	1,726,179	3,041,614	13,220,029,701
Shtesa gjate 2016 Pakesime	-	-	-	(130,521)	-	-	-	-
Vlera bruto e AAM me 31.12.2016	-	243,037,367	2,354,562,445	10,614,801,601	2,729,973	1,726,179	3,041,614	(130,521) 13,219,899,180
Amortizimi i akumuluar 31.12.2015	-	20,658,176	378,792,730	2,123,610,062	2,016,773	1,177,870	1,610,965	2,527,866,575
Pakesime	-	-	-	-	-	-	-	-
Amortizimi i vitit 2016	-	4,860,747	90,910,255	(60,652)	142,640	137,077	286,130	(60,652)
Amortizimi I akumuluar, 31 dhjetor 2016	-	25,518,923	469,702,985	2,613,371,798	2,159,413	1,314,947	1,897,095	586,159,237
Vlera neto e AAM 2016	-	217,518,444	1,884,859,459	8,001,429,803	570,560	411,232	1,144,520	10,105,934,019
Vlera neto e AAM 2015	-	222,379,191	1,975,769,714	8,491,322,060	713,200	548,309	1,430,650	10,692,163,125

Për Ndërtime, Ndërtime dhe Instalime, Makineri e pajisje amortizimi llogaritet sipas viteve të jetëgjatësisë, ndërsa për Mjetet e transportit, inventaret Ekonomik amortizimi llogaritet sipas normave fiskale.

Shënim: Amortizimi i aktiveve llogaritet me metodë linare sipas jetës së vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material për: (i) Ndërtesa; (ii) Ndërtesa dhe Instalime; (iii) Makineritë e Pajisjet duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes,

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2016 dhe 2015 është si më poshtë:
Kategoria e aktiveve Amortizimi

Ndërtesa 50 vite

Ndërtime dhe instalime 20-50 vite

Makinëri dhe pajisje 15-25 vite

Kjo metodë zbatohet për asetet e transferuara nga KESH sh.a. ne vitin 2012. Ekziston një grup asetesh në klasën Makineritë e Pajisjet te cilat janë blerë nga shoqëria në vite, amortizimi i të cilave llogaritet me metodën e amortizimit të vlerës së mbetur.
Ndërtesa: (i) Mjetet e Transportit; (ii) Pajisjet e zyrës; (iii) Pajisjet Informatike llogaritet me metodën e amortizimit të vlerës së mbetur sipas normave fiskale duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.

Termocentrali Vlorë sh.a
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016
(Vlerat janë në Lek)

6. Inventarë

Balancat e inventarit më 31 Dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshte:

	<u>31.12.2016</u>	<u>31.12.2015</u>
Nafta		
Materiale	1,108,772,645	1,109,364,518
Invenar imet	80,376,481	83,808,218
	120,165	123,885
	<u>1,189,269,291</u>	<u>1,193,296,622</u>

7. Llogari të arkëtueshme e të tjera arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme detajohen si më poshtë:

	<u>31.12.2016</u>	<u>31.12.2015</u>
Te tjera -Tecnimont	2,451,804	2,451,804
Te tjera te arketueshme (TVSH)	16,300,754	11,023,871
Te tjera te arketueshme	104,408	165,404
Tatim Fitimi	37,811,116	37,811,116
Akciza per tu rimbursuar	825,781,559	825,781,559
Zhvleresim i kerkeses per arketim per akcizen e naftes	(825,781,559)	(495,468,935)
	<u>56,668,082</u>	<u>381,764,819</u>

8. Shpenzime për të shpërndarë

Shpenzime për tu shperndarë

	<u>31.12.2016</u>	<u>31.12.2015</u>
Shpenzime për tu shperndarë	26,447,014	-
	<u>26,447,014</u>	<u>-</u>

9. Mjetet monetare

Gjendja e mjeteve monetare më 31 Dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshtë:

	<u>31.12.2016</u>	<u>31.12.2015</u>
Mjete monetare ne banke ne monedha te huaja (depozita)	677,922,003	685,388,712
Mjete monetare ne banke ne Leke	62,006,376	59,791,541
Mjete monetare ne arke	-	0
	<u>739,928,379</u>	<u>745,180,253</u>

Termocentrali Vlorë sh.a
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016
(Vlerat janë në Lek)

10. Kapitali

Kapitali i Shoqërisë është në vlerën 31,204,000 Lekë i ndarë në 31,204 aksione me vlerë nominale 1,000 Lekë për aksion. Aksionet zotërohen 100% nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare .

31.12.2016

Nr.Pjeseve	Vlera nominale e aksionit	Struktura	Kapitali i aksionar
			Lekë
KESH sha.	31,204.00	1,000.00 100%	31,204,000.00
Rezervat ligjora nuk kanë pësuar ndryshime , ato janë në vlerën 1,560,200 Lekë.			
Rezervat e tjera të Shoqërisë nuk kane pasur ndryshime dhe janë në vlerën 225,747,682 Lekë .			
Fitim/humbjet e mbartura janë në vlerën (1,525,146,871)Lekë [2015: 8,924,079 Lekë].			
Fitim/humbjet e vitit ushtrimore është në vlerën (1,156,466,415) Lekë [2015: 1,516,222,789 Lekë].			

11. Hua afatgjata

Huatë afatgjata më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 detajohet si më poshtë :

	31.12.2016	31.12.2015
Hua afatgjata	6,066,490,930	7,694,740,765
	6,066,490,930	7,694,740,765

12. Grante, të ardhura të shtyra dhe të tjera detyrime

Balanca e granteve të ardhurave të shtyra dhe të tjera detyrimeve më 31 Dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshtë:

	31.12.2016	31.12.2015
Grante,te ardhura te shtyra e te tjera detyrime	58,247,255	59,184,004
	58,247,255	59,184,004

13. Hua afatshkurtra nga KESH sh.a

Huatë afatshkurtra të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2016 dhe 2015 detajohen si më poshtë:

	31.12.2016	31.12.2015
Hua afat shkurter	7,506,099,648	5,981,797,534
Interesa te huave	526,247,208	299,867,538
Financime te tjera nga KESH sh.a.	305,778,787	177,623,361
Siguracion asetesh (KESH SH.A.)	33,990,000	-
Sherbim rojesh (KESH SH.A.)	1,625,845	-
Financim Energji Elektrike nga KESH	13,690,216	8,844,418
	8,387,431,704	6,468,132,851

Shënim: Eshtë sistemuar për vitin 2015 financimi për blerje energji elektrike nga KESH sh.a për shumën prej 8,844,418 lekë. Sistemi është bërë:

Ishte tek detyrime të tjera të pagueshme, kalon tek Hua afatshkrutëra nga KESH sh.a.

14. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 detajohen si më poshtë :

	<u>31.12.2016</u>	<u>31.12.2015</u>
Furnitore vendas	2,089,989	27,973,260
Furnitore te huaj	21,387,260	21,711,477
	<u>23,477,249</u>	<u>49,684,737</u>

Shënim: Eshtë sistemuar për vitin 2015 financimi për blerje energji elektrike nga KESH sh.a për shumën prej 8,844,418 lekë. Sistemi është bërë:
Ishte tek detyrime të tjera të pagueshme, kalon tek Hua afatshkrutëra nga KESH sh.a .

15. Detyrimet tatimore

Detyrimet tatimore të kompanisë më 31 Dhjetor 2016 dhe 2015 detajohen si më poshtë :

	<u>31.12.2016</u>	<u>31.12.2015</u>
Sigurime shoqerore e shendetsore	1,203,121	1,211,853
Tatim mbi te ardhurat personale	818,737	877,592
Tvsh per tu paguar (neto)	-	-
Tatim Burim	143,708	19,381
Shteti tatim fitimi	-	-
	<u>2,165,566</u>	<u>2,108,826</u>
Numri punonjesve	61	61

16. Detyrime të tjera

Detyrime të tjera më 31 Dhjetor 2016 dhe 2015 përbëhen si më poshtë:

	<u>31.12.2016</u>	<u>31.12.2015</u>
Paga per tu paguar personelit	3,272,107	3,050,185
Honorare per KM	150,875	-
Detyrime te tjera	88,200	88,200
Detyrime ndaj KESH security	-	2,025,696
Detyrime te Tjera	24,242	24,542
	<u>3,535,425</u>	<u>5,188,623</u>

17. Të ardhura nga shitja

Të ardhurat nga shitja e energjisë dhe të ardhurat e tjera për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016 dhe 2015 detajohen si më poshtë :

	<u>31.12.2016</u>	<u>31.12.2015</u>
Te ardhura nga shitja e energjise	-	-
	<u>-</u>	<u>-</u>

18. Të ardhura të tjera

Të ardhurat e tjera të Shoqërisë për 31 Dhjetor 2016 dhe 2015 detajohen si më poshtë :

	<u>31.12.2016</u>	<u>31.12.2015</u>
Rimarje subvencioni per AAM te falura	605,700	811,560
Rimarje subvencioni per materiale te falur nga Italianet	331,048	2,395,800
Te ardhura te tjera (arketim nga telefonat)	-	188,875
Te ardhura nga mbyllja e detyrimit ndaj KESH Secutity	2,025,696	-
Te ardhura (dhurim nga KESH) Naftë	1,385,845	-
Fitime nga gabime te lejuara	-	294,898
	<u>4,348,289</u>	<u>3,691,133</u>

19. Materiale të para dhe të konsumueshme

Shpenzimet për materialet e para dhe të konsumueshme për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016 dhe 2015 janë si më poshtë :

	<u>31.12.2016</u>	<u>31.12.2015</u>
Materiale të para	591,874	637,278
Materialë ndihmës	181,895	1,185,075
Pjesë ndërrimi	388,471	2,322,930
Kimikate	2,942,151	3,981,312
Pajime sigurie	27,700	33,750
Materiale - elektrike	116,770	460,360
Materiale - Mekanike	360,082	205,485
Materiale - hidraulike	45,300	86,335
Materiale - Zyre	176,667	-
Materiale - Mirembajtje e sistemeve	-	442,400
Materiale per linjen e furnizimit ne det	76,647	109,241
Karburant per makinat	1,936,694	2,130,022
Vajra lubrifikante dhe vajra transformatori	63,150	2,455,280
Inventar i imet	3,720	2,975
Materiale te tjera	3,278,001	981,004
	<u>10,189,122</u>	<u>15,033,447</u>

20. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016 dhe 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31.12.2016</u>	<u>31.12.2015</u>
Pagat bruto	44,835,206	44,393,190
Kontribute sigurmi shoqerore	8,420,075	8,518,253
Shpenzime te tjera per personelin	11,504,015	11,396,230
	<u>64,759,296</u>	<u>64,307,673</u>

21. Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi

Shpenzimet e amortizimit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016 dhe 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31.12.2016</u>	<u>31.12.2015</u>
Amortizimi I AAM	586,159,237	587,072,314
Shpenzime zhvlerësimi te arketueshe	330,312,624	495,468,935
	<u>916,471,861</u>	<u>1,082,541,249</u>

22. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit detajohen si më poshtë :

	<u>31.12.2016</u>	<u>31.12.2015</u>
Blerje energji ,avull,uje,tj	4,208,694	7,663,633
Mirembajtje dhe riparime	1,944,997	1,458,100
Shpenzime siguracione	7,542,986	34,000,000
Sherbime te tjera	2,269,340	3,525,055
Sherbim i ruajtjes dhe sigurise	14,374,032	16,711,680
Personel jashtë njesisë	2,130,000	2,072,917
Transferime, udhëtime, dieta	461,500	627,500
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	158,258	421,808
Shpenzime transporti	1,193,039	1,217,689
Shpenzime për shërbimet bankare	100,249	112,972
Shpenzime nxjerrje jashte perdorimit	83,843	-
Gjoha dhe dëmshpërblime	6,105,367	4,872,435
	<u>40,572,306</u>	<u>72,683,789</u>

23. Shpenzime interesi dhe të ngjashme e të tjera financiare

Shpenzimet e interesit dhe të ngjashme për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016 dhe 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31.12.2016</u>	<u>31.12.2015</u>
Te ardhura nga interesat e llog. bankare	3,598,405	8,139,743
Shpenzime nga interesat e llog.bankare	(27,701)	(23,722)
Shpenzime per interesa kredie afat gjate	(230,802,943)	(257,526,295)
Shpenzime nga vlersime te kursit kembimit valutore	(67,695,027)	(262,985,950)
Te ardhurat nga vlersimi kursit kembimit valutore	166,105,204	227,048,458
	<u>(128,822,063)</u>	<u>(285,347,766)</u>

24. Rezultati Tatimore

➤ Riparaqitje të shpenzimeve të panjohura të vitit 2015:

	<i>Bëhet</i> <u>31.12.2015</u>	<i>Ndryshimet</i>	<i>Ishte 31.12.2015</i>
Fitimi (Humbje) para Tatimit	<u>(1,516,222,791)</u>		<u>(1,516,222,791)</u>
Shpenzime te panjohura (Gjoha e interesa tatimore)	4,872,435		4,872,435
Shpenzime te panjohura te tjera per interes	-		-
Shpenzime te panjohura te Interesat banka	257,550,017	257,550,017	-
Shpenzime te panjohura per Privizionet	495,468,935	495,468,935	-
Humbje e mbartur nga viti kaluar			-
Fitimi (Humbje) Tatimore	<u>(758,331,404)</u>	753,018,952	<u>(1,511,350,356)</u>
Tatimi mbi Fitimin (15 %)			-
Fitimi (Humbje) NETO	<u>(1,516,222,791)</u>	-	<u>(1,516,222,791)</u>

➤ Përlllogaritja e rezultatit tatimore 2016 paraqitet si më poshtë :

	31.12.2016	31.12.2015
Fitimi (Humbje) para Tatimit	(1,156,466,358)	(1,516,222,791)
Shpenzime te panjohura (Gjoha e interesa tatimore)	6,105,367	4,872,435
Shpenzime te panjohura te tjera	10,873,300	-
Shpenzime te panjohura te Interesat bankare	230,830,644	257,550,017
Shpenzime te panjohura per Privizionet	330,312,624	495,468,935
Humbje e mbartur nga viti kaluar	-	-
Fitimi (Humbje) Tatimore	(578,344,423)	(758,331,404)
Tatimi mbi Fitimin (15 %)	578 344 423	-
Fitimi (Humbje) NETO	(1,156,466,358)	(1,516,222,791)

25. Transaksionet me palët e lidhura

Transaksionet me palët e lidhura me impakt në pasqyrën e pozicionit financiar dhe në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse paraqiten si më poshtë :

	31 Dhjetor 2016		31 Dhjetor 2015	
	Të arketueshme	Të Pagueshme	Të arketueshme	Të Pagueshme
KESH sha	-	14,453,922,626	-	14,162,873,614
KESH Kredia WB 38720 USD	-	3,018,343,660	-	2,962,295,771
KESH Kredia EBRD 33833 euro	-	5,238,887,719	-	5,318,305,894
KESH Kredia EIB 22706 euro	-	5,315,359,198	-	5,395,936,632
KESH Detyrim per interesa te kredise WB 38720 USD	-	62,165,060	-	24,275,761
KESH Detyrim per interesa te kredise EBRD 33833 euro	-	56,153,357	-	34,638,689
KESH Detyrime per interesat e kredise EIB 22706 Euro	-	407,928,792	-	240,953,088
Financime KESH SH.A.	-	305,778,787	-	177,623,361
Siguracion asetesh (KESH SH.A.)	-	33,990,000	-	-
sherbim rojesh (KESH SH.A.)	-	1,625,845	-	-
Financim Energji Elektrike nga KESH	-	13,690,208	-	8,844,418
KESH Sesurity sh.a	-	-	-	-
	-	14,453,922,626	-	14,162,873,614

Termocentrali Vlorë sh.a

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016

(Vlerat janë në Lek)

	31 Dhjetor 2016		31 Dhjetor 2015	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
KESH sha				
Per Sigurim te AQT te TEC Vlore ne viti 2016	-	14,014,629	-	-
Shpenzime për tu shperndarë	-	33,990,000	-	7,394,113
Per ruajtje objekti ne vitin 2016	-	(26,447,014)	-	-
Shitje energjise elektrike gjate vitit 2016	-	1,625,845	-	-
	-	4,845,798	-	-
KESH Security sh.a				7,394,113
	-	-	-	16,711,680
	-	14,014,629	-	24,105,793

Të tjera informacione për palët e lidhura.

	31.12.2016	31.12.2015
Administrator	1,440,000	1,440,000
Keshilli Mbikqyres	2,130,000	2,130,000
	3,570,000	3,570,000
	Nr	Nr
Administratore	1	1
Keshill Mbikqyres	7	7
	8	8

26. Manaxhimi i riskut financiar

Detyrimet financiare kryesore të Shoqërisë përbëhen nga llogaritë e pagueshme dhe të tjera detyrime. Qëllimi kryesor i këtyre detyrimeve financiare është të financojnë operacionet e Shoqërisë dhe të sigurojnë garanci për mbështetjen e operacioneve. Shoqëria ka hua, llogari të arkëtueshme, mjete monetare dhe depozita afatshkurtra që sigurohen drejtpërdrejtë nga operacionet e saj. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të tregut, riskut të kreditit dhe riskut të likuiditetit. Manaxhimi i lartë i Shoqërisë mbikqyr manaxhimin e këtyre risqeve.

Risku i tregut

Risku i tregut është risku që vlera e drejtë e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut. Çmimet e tregut përfshijnë katër lloje risqesh: risku i normës së interesit, risku i kursit të këmbimit, risku i çmimit të mallrave dhe risqe të tjera të çmimeve, të tilla si risku i çmimit të kapitalit. Instrumentat financiar të prekur nga risku i tregut përfshijnë huatë, kreditë dhe depozitat.

Risku i normave të interesit

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në treg dhe riskut që maturitetet e aktiveve që mbartin interes të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes të përdorura për të financuar ato aktive. Zgjatja kohore përgjatë të cilës norma e interesit e një instrumenti financiar është fikse, përcakton se në çfarë mase është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit.

Aktivët dhe detyrimet e Shoqërisë mbartin risk të normave të interesit.

	31.12.2016	31.12.2015
Instrumenta me interes fik		
Aktive Financiare	-	-
Detyrime Financiare	-	-
Instrumenta me interes variabel		
Aktive Financiare	-	-
Detyrime Financiare	-	-
	13,572,590,578	13,676,538,299
	13,572,590,578	13,676,538,299

Risku i kreditit

Risku i kreditit është risku që një palë tjetër nuk do të jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj që rrjedhin nga një instrument financiar ose marrëveshje klienti, duke çuar kështu në një humbje financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kreditit për shkak të aktiviteteve operacionale të saj (pikë së pari prej llogarive të arkëtueshme) dhe prej aktiviteteve të saj financuese, që përfshijnë depozitat me bankat dhe institucionet financiare, transaksionet në monedha të huaja dhe instrumenta të tjerë financiare. Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit.

Përshkrimi	31 Dhjetor 2016			Total
	Deri në 6 muaj	6 -12 muaj	1 - 5 vjet	
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	56,668,082			56,668,082
Shpenzime për tu shperndarë	26,447,014			26,447,014
Mjete monetare në arkë dhe bankë	739,928,379			739,928,379
	823,043,475	0	0	823,043,475

Përshkrimi	31 Dhjetor 2015			Total
	Deri në 6 muaj	6 -12 muaj	1 - 5 vjet	
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	51,452,195	330,312,624		381,764,819
Mjete monetare në arkë dhe bankë	745,180,253	-		745,180,253
	796,632,448	330,312,624	0	1,126,945,072

Risku i Likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria mund të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj të lidhura me detyrimet financiare në momentin e pagesës. Risku i likuiditetit është risk i qenësishëm në biznesin e Shoqërisë pasi disa aktive specifike të blera apo detyrime të shitura mund të kenë karakteristika likuiditeti që janë specifike. Nëse Shoqërisë do ti duhet të ketë shuma të mëdha në një afat të shkurtër kohor që tejkalon kërkesat normale për mjete monetare mundet që të ndeshet me vështirësi për të siguruar çmime konkurruese. Shoqëria manaxhon riskun e likuiditetit duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar të përputhë profilet e maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve.

Termocentrali Vlorë sh.a

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016

(Vlerat janë në Lek)

	Nga 1 deri në 12 muaj	Nga 1 deri në 5 vjet	Më shumë se 5 vjet	Totali
31 Dhjetor 2016				
Llogari të arkëtueshme e të tjera	56,668,082	-	-	56,668,082
Shpenzime ter tu shperndare	26,447,014	-	-	26,447,014
Mjetet monetare në arkë e në bankë	62,010,572	677,917,806	-	739,928,379
shuma	145,125,669	677,917,806	-	823,043,475
Detyrimet e pagueshme të tjera	(29,178,240)	-	-	(29,178,240)
Interesa KESH	(526,247,208)	-	-	(526,247,208)
Financim KESH	(305,778,787)	-	-	(305,778,787)
Siguracion asetesh (KESH SH.A.)	(33,990,000)	-	-	(33,990,000)
sherbim rojesh (KESH SH.A.)	(1,625,845)	-	-	(1,625,845)
Financim Energji elektrike	(13,690,216)	-	-	(13,690,216)
Huate	(7,506,099,648)	(4,969,112,199)	(1,097,378,731)	(13,572,590,578)
shuma	(8,416,609,944)	(4,969,112,199)	(1,097,378,731)	(14,483,100,874)
Rreziku I likuiditetit më 31 dhjetor 2016	(8,271,484,276)	(4,291,194,393)	(1,097,378,731)	(13,660,057,399)
31 Dhjetor 2015				
Llogari të arkëtueshme e të tjera	51,452,195	330,312,624	-	381,764,819
Mjetet monetare në arkë e në bankë	59,792,301	685,387,951	-	745,180,252
shuma	111,244,496	1,015,700,575	-	1,126,945,072
Detyrimet e pagueshme të tjera	(56,982,187)	-	-	(56,982,187)
Interesa KESH	(299,867,538)	-	-	(299,867,538)
Financim KESH	(177,623,361)	-	-	(177,623,361)
Financim Energji elektrike	(8,844,418)	-	-	(8,844,418)
Huate	(5,981,797,534)	(5,179,556,118)	(2,515,184,647)	(13,676,538,299)
shuma	(6,525,115,037)	(5,179,556,118)	(2,515,184,647)	(14,219,855,802)
Rreziku I likuiditetit më 31 dhjetor 2015	(6,413,870,541)	(4,163,855,543)	(2,515,184,647)	(13,092,910,731)

Risku i monedhës

Shoqëria ndërmerr transaksione në monedhë të huaj si pasojë e ekspozimit ndaj luhatjeve të kurseve të këmbimit. Ekspozimi ndaj kurseve të këmbimit manaxhohet duke përcaktuar një politikë midis të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve. Vlera kontabël neto e aktiveve dhe detyrimeve monetare të shoqërisë sipas monedhave për vitin që u mbyll janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

	Më 31 Dhjetor 2016			Më 31 Dhjetor 2015		
	Aktive financiare monetare	Detyrime financiare monetare	Pozicioni neto i bilancit	Aktive financiare monetare	Detyrime financiare monetare	Pozicioni neto i bilancit
LEK	145,121,472	384,263,148	(239,141,675)	441,556,360	243,449,966	198,106,394
EUR	677,922,003	11,018,329,066	(10,340,407,063)	685,388,712	10,989,834,303	(10,304,445,591)
USD	-	3,080,508,720	(3,080,508,720)	-	2,986,571,532	(2,986,571,532)
GBP	-	-	-	-	-	-
CHF	-	-	-	-	-	-
Totali	823,043,475	14,483,100,933	(13,660,057,458)	1,126,945,072	14,219,855,800	(13,092,910,729)

27. Vlera e drejtë e instrumentave financiare

Instrumentat financiare përfshijnë aktivet dhe detyrimet financiare. Aktivet financiare përbëhen nga gjendja e llogarive në bankë dhe të arkëtueshmet. Detyrimet financiare përbëhen nga të pagueshmet. Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare përfshihet në shumën në të cilën instrumenti mund të shkëmbëhet në një transaksion mes palëve të gatshme, dhe jo të detyrueshme të në një proces likuidimi ose shitje. Vlerat e drejta të të gjitha aktiveve financiare të shoqërisë përafrojnë vlerat e tyre kontabël kryesisht për shkak të maturimit afatshkurtër të këtyre instrumentave.

28. Angazhime dhe detyrime të kushtezuara

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

29. Ngjarje pas datës së raportimit financiar

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pasdatës së raportimit të cilat do të kërkonin korrigjim ose shënime në pasqyrat financiare.

Besnik KENDEZI
Administrator i TEC Vlore sh.a



Dorina KAMBERAJ
Hartues i pasqyrave financiare

Vullnet BILBILAJ
Drejtore i Drejtorise Ekonomike